

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit (Programi: Master i mësimdhënies në matematikë)
Titulli i lëndës:	<b>Hulumtimi në veprim</b>
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II (Sem IV)
Numri i orëve në javë:	(2+1 orë)
Vlera në kredi – ECTS:	5 ECTS
Koha / lokacioni:	E hënë 14.00 - 15.30
Mësimdhënësi i lëndës:	<b>Prof.Dr. Eda Vula</b>
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:eda.vula@uni-pr.edu">eda.vula@uni-pr.edu</a> ;
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<p>Ky kurs është planifikuar me qëllim të njohjes me hulumtimin në veprim si një formë e kërkimit sistematik dhe si proces i reflektimit për praktikën mësimore në lëndën e matematikës. Në këtë kurs do të shqyrtohen hapat e implementimit të një projekti hulumtues në klasë, shkollë dhe institucionet tjera arsimore.</p> <p>Studentët do të analizojnë një shumëllojshmëri të perspektivave të qëllimeve të hulumtimit në veprim, bazën teorike, etikën, proceset dhe çështjet e përfshira në planet e veprimit. Ata do të shqyrtojnë karakteristikat themelore të hulumtimit në veprim dhe llojet e tyre, identifikimin e problemeve, hapat e realizimit të hulumtimit në klasë dhe raportimin e tyre.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i këtij kursi është përgatitja e studentëve për zbatimin e praktikave efikase të mësimdhënies së matematikës nëpërmjet zhvillimit të projekteve hulumtuese në klasë.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>shqyrtojnë lidhjen midis teorisë, hulumtimit dhe praktikave të mësimdhënies së matematikës;</li> <li>analizojnë në mënyrë kritike artikujt dhe literaturën shkencore në lidhje me problemet e identifikuara të fushës së edukimit matematikor;</li> <li>shqyrtojnë ndikimin e hulumtimit në veprim në përmirësimin e praktikave mësimore;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>demonstrojnë aftësi për planifikimin dhe zhvillimin e një cikli të hulumtimit në klasë/shkollë;</li> <li>zhvillojnë një projekt hulumtimi dhe shkruajnë raportin e atij hulumtimi;</li> <li>reflektojnë rreth praktikës profesionale në kontekst të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe të rezultateve të nxënies në fushën e matematikës</li> </ul>
--	---

**Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	8	8
Ushtrime në teren	2	4	8
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë	2	12	24
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	12	36
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet,prezentimet ,etj	2	2	4
<b>Totali</b>			<b>127</b>

**127 : 25 ≈ 5 ECTS**

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Në këtë kurs do të zbatohen metodat ndërvepruese të mësimdhënies, duke i angazhuar studentët në diskutime për çështje të rëndësishme, duke u bërë të mundur që të reflektojnë mbi përvojën e tyre dhe duke i lejuar ata të shprehin idetë e tyre, besimet, dhe përvojat rreth temave të caktuara në kontekst të përmirësimit të praktikës së tyre profesionale.
-------------------------------------	---



Java e gjashtë:	Planifikimi i veprimit – llojet e dizajneve të HV
Java e shtatë:	Mbledhja e të dhënave sasiore. Hartimi i planit për mbledhjen e të dhënave; teknikat dhe metodat për mbledhjen e të dhënave (I)
Java e tetë:	Mbledhja e të dhënave cilësore. Hartimi i planit për mbledhjen e të dhënave; teknikat dhe metodat për mbledhjen e të dhënave (II)
Java e nëntë:	Analiza dhe interpretimi i të dhënave sasiore.
Java e dhjetë:	Analiza dhe interpretimi i të dhënave cilësore
Java e njëmbëdhjetë:	Diskutimi i rezultateve të projekteve me ‘miqtë kritik’
Java e dymbëdhjetë:	Procedurat e shkrimit dhe prezantimi i një projekti hulumtues. Hulumtimi në veprim si metodologji në tezën e Masterit
Java e trembëdhjetë:	Testi
Java e katëmbëdhjetë:	Prezantimi i projekteve hulumtuese
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimi i projekteve hulumtuese

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Çdo student duhet të:

- Viojë me rregull ligjëratat;
- Lexojë literaturën e kërkuar dhe artikujt e sugjeruar, të marrë pjesë në diskutime në klasë, të përgatitet për të gjitha aktivitetet tjera;
- Përgatisë dhe të dorëzojë të gjitha detyrat në kohën e duhur. Çdo vonese do të ndëshkohet me pikë të humbura;
- Përdorë stilin APA në të gjitha detyrat e shkruara
- Prezantojë raportin e projektit hulumtues të tij/saj në klasë;
- Kopjimet/plagjiatura gjatë provimeve dhe kryerjes së detyrave ndëshkohen sipas procedurave të miratuara në KF
- Gjatë orëve mësimore nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë dhe ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye.